



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:134981
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05528525

Ac.nr.8089/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përbarimore të kreditores Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike (KESCO), sh.a me seli në Prishtinë, rr. Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, ndërtesa ElektroKosova, Kati II, kundër debitorit H. R. S. nga fshati, Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.V., avokat në Prishtinë, me bazë juridike përbarimore borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, PPP.nr.180/2022, të datës 18.10.2022, më 26.03. 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), Bulevardi Bill Klinton, Nr.5, Ndërtesa Elektrokosova, Kati II, Prishtinë, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, PPP.nr.180/2022, i datës 18.10.2022 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren Dega në Suharekë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.180/2022, të datës 18.10.2022, ka vendosur si në vijim:

APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit H. R. S. nga fshati komuna Suharekë, përfaqësuar nga avokat L.V. nga Prishtina, ndërsa urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat, Saranda Kuçi, P.nr. 70/2022, i datës 20.6.2022, anulohet pjesërisht për shkak të parashkrimit të kërkesës së kreditorit, dhe atë për periudhën kohore nga data 30.6.2016, e deri më 13.6.2020, në shumë prej 2,093.11 euro, ku për këtë pjesë të borxhit, refuzohet pjesërisht propozimi përmbartimor i kreditorit.

REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit i theksuar si në pikën I të këtij aktvendimi, ndërsa urdhri përmbartimor i lartcekur, Vërtetohet pjesërisht, për periudhën kohore nga data 14.07.2020, e deri më 15.05.2022 për shumën e borxhit prej 924.16 euro. Secila palë i kompenson shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e parashtruar, të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të mbetet ne fuqi urdhri për përmbartim i përmbartuesit privat, ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje dhe të obligohet debitori që ti bartë shpenzimet për ankesë në lartësi sipas udhëzimit administrativ 01/2017, për taksat gjyqësore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditores është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike (KESCO) sh.a., me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit H. R. S. nga fshati, Komuna e Suharekës, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste....., lidhur me shumën e detyrimit në lartësi prej 3,017.27 €, për periudhën prej 30.06.2016 deri me datën 14.05.2022.

Përmbartuesi private Saranda Kuçi, me urdhrin P.nr.70/22, të datës 20.06.2022, e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit. Ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, debitori ka ushtruar prapësim me datë 30.06.2022, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 30.06.2022. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit e ankimuar.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim

të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 360, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 368 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, kur ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.70/2022, të datës 20.06.2022, sa i përket borxhit në vlerë prej 2,093.11 €, dhe duke lënë në fuqi urdhrin e lartcekur për përmbarim sa i përket vlerës së borxhit prej 924.16 €. Gjykata e Apelit tani për tani, nuk e pranon këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me parashkrimin, pasi që në bazë të shkresave të lëndës shihet se debitori ka bërë pagesa të cilat rezultojnë se kanë ndikuar në ndërprerje të parashkrimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se në bazë të nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se “afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”, që do të thotë se nuk numërohet viti në të cilin është dashur të përmbushet kërkesa e arritur, ashtu që për kërkesat e tilla që janë krijuar gjatë vitit 2013, afati i parashkrimit do të fillojë nga 1 janari i vitit 2014 deri në ditën e fundit të vitit 2014, e kështu për çdo vit pasues. Po ashtu, me dispozitën e nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shkresat e lëndës respektivisht nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist për pagesën e shërbimeve komunale për konsumin e energjisë elektrike DPZ-9030457, është vërtetuar se debitori kohë pas kohe ka realizuar pagesa përgjatë gjithë periudhës për të cilën është kërkuar borxhi nga kreditori, përkatësisht me datën 05.07.2021 në vlerë prej 159.98 të precizuar si pagesë e energjisë elektrike duke paguar kështu në emër të borxhit të përgjithshëm e jo duke specifikuar obligimin për secilën faturë veç e veç, mirëpo të njëjtat nuk korrespondojnë në muaj të specifikuar që me anë të këtyre pagesave të bëhet pranimi i borxhit dhe rrjedhimisht edhe kemi të bëjmë me ndërprerjen e parashkrimit, ku në këtë rast parashkrimi i kërkesave rrjedh për secilën faturë veç e veç e që pagesa e kësteve në emër të borxhit, e jo në emër të faturës së specifikuar do të thotë pranimi i borxhit, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja t’i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të shqyrtojë me kujdes shkresat e lëndës, sidomos dokumentin e besueshëm, duke vlerësuar nëse borxhi i krijuar për periudhën e përcaktuar në propozim për përmbarim (30.06.2016 - 14.05.2022) korrespondon me borxhin e kërkuar nga kreditori, ashtu që në rast se ekziston s’përputhje, gjykata mund të kërkojë nga kreditori precizimin e borxhit, e pas eliminimit të të

metave të lartcekurave, të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore, duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

Ac.nr.8089/22, më 26.03.2024

Gjyqtare
Hunaida Pasuli